



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT

Nr. ____ prot

Tiranë më ____/ ____/ 2025

SHPLLJE
PËR VEND TË LIRË PUNE
DREJTOR EKZEKUTIV I INSTITUTIT PËR STUDIMIN E KRIMEVE DHE
PASOJAVE TË KOMUNIZMIT

Në mbështetje të ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar, Nenit XII të “Rregullores për Funksionimin e Bordit”, e ndryshuar dhe Vendimit Nr. 3. datë 22.04.2025 të Institutit për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, Instituti shpall procedurat e konkurimit për vendin e lirë:

DREJTOR EKZEKUTIV I INSTITUTIT PËR STUDIMIN E KRIMEVE DHE
PASOJAVE TË KOMUNIZMIT
(1 pozicion), kategoria e pagës I-II

I. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PUNËS

- a) Drejtori Ekzekutiv përfaqëson institutin në marrëdhënie me të tretët.
- b) Përgatit të gjitha materialet, që shqyrton dhe miraton Bordi dhe përgjigjet për zbatimin e vendimeve të bordit;
- c) Merr pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Bordit;
- d) I propozon kryetarit të bordit datën e mbledhjes dhe rendin e ditës;
- e) U propozon organeve/institucioneve, që parashikon ligji, sanksione për shkeljet administrative, të bëra nga institucionet që kanë ruajtur materialet arkivore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat, dosjet dhe informacionin e klasifikuar;
- f) Emëron dhe liron punonjësit e institutit;

- g) Nënshkruan akte bashkëpunimi me titullarët e institucioneve, që zotërojnë dokumente e materiale arkivore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, që rregullojnë ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e dokumenteve e të materialeve arkivore të kësaj
- h) Organizon, drejton, kontrollon dhe përgjigjet për sigurimin e zbatimit të detyrave dhe kompetencave që ka Instituti;
- i) Koordinon veprimtarinë e punës për zbatimin e detyrave sipas akteve ligjore dhe nënligjore;
- j) Planifikon aktivitetin në mbështetje të detyrave të caktuara për të siguruar realizimin në kohë të objektivave të përcaktuar;

II. KRITERET E POZICIONIT TË PUNËS

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshmes vijon:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e detyrueshme për të vazhduar konkurrimin si vijon:

- a) Kriteri sipas Kreut IV , Neni 18 të ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar.
- b) Minimumi Master shkencor ose e barazvlefshme me të, në shkenca Shoqërore dhe Humane
- c) Eksperienca e punës jo më pak se 10 vite pune.

Përbëjnë avantazh

- a) Njohja shumë e mirë e gjuhës angleze
- b) Gradat Shkencore;
- c) Aftësi komunikimi;
- d) Aftësi të drejtimit strategjik;
- e) Ndërtim i marrëdhënieve ndërpersonale;
- f) Efektivitet;
- g) Aftësi pune në grup;
- h) Kuptim të gjerë të kompetencave ndërsektoriale;

- i) Njohuri mbi fenomenet sociale dhe ekonomike të historisë së komunizmit: artikuj shkencorë, monografi;
- j) Besueshmëri;
- k) Vizion;
- l) Të qenët krijues;
- m) Integritet;
- n) Njohuri për sistemin ligjor evropian për çështjet e komunizmit.

III. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesën;
- b) Jetëshkrimin;
- c) Fotokopjen e kartës së identitetit;
- ç) Fotokopjet e noterizuara të diplomës të arsimit të lartë;
- d) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës;
- dh) Kandidati duhet të paraqesë një platformë apo vizion për drejtimin e ISKK.
- e) Raportin mjekoligjor mbi gjendjen shëndetësore;
- e) Çertifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
- j) Vërtetimin që të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna;
- k) Vërtetime që plotëson kriterin e posaçëm sipas Kreut IV, Neni 18, të ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar .
- l) Çdo çertifikat apo diplomë që vërteton kualifikime shtesë.

Dokumentat duhet të dorëzohen dorazi ose me postë në Sekretarinë e Institutit për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri deri në datë 19.05.2025
(Adresa rruga e Saraçëve , Te Selvia , Tiranë)

IV. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT

Pas verifikimit të dokumentacionit, **brënda 10 ditëve**, Njësia e Burimeve Njerëzore në ISKK do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të ISKK, në stendat e informimit të publikut në ambientet e ISKK, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista për kandidatët e kualifikuar. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen nga njësia përgjegjëse dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë saj, për t’u njohur me arsyet e moskualifikimit. Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë)

ditëve pune nga shpallja e listës pranë njësisë përgjegjëse. Njësia përgjegjëse duhet të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune e, kur është rasti, bën korrigjimin e listës dhe merr masa për publikimin e listës së korrigjuar.

V. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlersimi kandidatve dhe përzgjedhja e fituesit do të bëhet nga Bordi i Institutit sipas pikes b), neni 11, të ligjit Nr. 10 242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar.

VI. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bordi do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të ISKK dhe në stendat e informimit të publikut të ISKK pas 5 ditësh nga data e konkurimit.

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE
Zoica Graçi